

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR

NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.298 DATË 20.04.2016 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË TURIZMIT” TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Projektvendimi ka si qëllim shtimin e kompetencave të Agjencisë Kombëtare të Turizmit (AKT) duke u fokusuar në hartimin e kalendarin turistik të aktiviteteve zbavitëse me karakter kombëtar në bashkëpunim me institucionet qendrore, njësitet e vetëqeverisjes vendore dhe grupet e interesit në fushën e turizmit si dhe monitorimin e tij.

Gjithashtu projektvendimi përcakton detyrimin e AKT për monitorimin e zbatimit dhe realizimit të projekteve krijuar për promovimin e turizmit, si dhe të ngjarjeve që janë të përfshira në kalendarin turistik të cilat do të financohen nga fondi buxhetor i miratuar për projektet.

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet krijimi i një kalendar kombëtar gjithëvetor i cili do të përfshijë evente dhe ngjarje të spikatura kulturore, të traditës, sportive dhe natyrore, të cilat ofrojnë zbavitje dhe kënaqësi për turistët në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe nxitja dhe mbështetja e projekteve inovative në fushën e turizmit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Miratimi i këtij projektvendimi nuk është parashikuar në programin analistik të akteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2024, por është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për një ndryshim dhe disa shtesa në vendimin nr. 298, datë 20.4.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, i ndryshuar

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim vjen si rezultat i ndryshimeve ligjore që pësoi Ligji 93/2015 "Për turizmin" i ndryshuar, nëpërmjet Ligjit nr. nr. 30/2024, datë 4.4.2024, në nenin 14 të tij, "Funksionet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Turizmit" (AKT).

Me qëllim tërheqjen e vizitave të turistëve vendas dhe të huaj, jo vetëm në zonat tradicionale turistike por edhe në zonat e tjera të vendit, u parashikua hartimi i kalendarit turistik të aktiviteteve zbavitëse i cili në vetvete është një program gjithëvjetor, që përfshin të gjitha ngjarjet kulturore, të traditës, sportive dhe natyrore dhe që ofron zbavitje dhe kënaqësi për turistët në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ky kalendar publikohet çdo vit në faqen zyrtare të ministritës përgjegjëse për turizmin dhe të institucionit përgjegjës për promovimin e turizmit (AKT), si dhe në platformat online të menaxhuara prej tij.

AKT do të orientojë zhvillimin e eventeve në lidhje me shtrirjen gjeografike dhe kohën më të përshtatshme si dhe do të luaj rolin e koordinatorit për të gjitha ngjarjet pjesë e kalendarit kombëtar të festave, me qëllim mbarëvajtjen e tyre.

Për përfshirjen e ngjarjeve, aktiviteteve në kalendarin turistik, të cilat organizohen nga institucione publike dhe private, AKT bën vlerësimin bazuar në vlerat që do të përcillen si dhe në ndjekshmërinë që parashikohet të ketë gjatë zhvillimit të tyre.

Gjithashtu ky projektakt do të krijojë mundësinë për mbështetjen nga AKT të projekteve inovative e me karakter krijues, të cilët kanë për qëllim kryesor promovimin e turizmit.

Në këtë projektakt janë detajuar llojet shërbimeve të promocionit prej të cilave AKT do të krijojë të ardhura dytësore.

Nëpërmjet të ardhurave që do të sigurohen, AKT-së i krijohet mundësia për të rritur numrin e subjekteve turistike që do të promovojnë brenda dhe jashtë territorit të vendit, në panaire të turizmit, në një hapësirë të përbashkët, nën logon e Shqipërisë.

Gjithashtu të ardhurat dytësore do të krijojnë mundësinë për përmirësimin e shërbimit të promovimit online si dhe do të rrisë numrin e subjekteve të cilët ushtrojnë veprimitari në fushën e turizmit ose të lidhura indirekt me të, për tu promovuar online në faqen e AKT apo në platforma të tjera.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektvendimi hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin” i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE).

Projektvendimi nuk synon transpozimin e *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.

Në këtë projektvendim parashikohen të bëhet një ndryshim dhe shtesat me përbajtjen si më poshtë:

Në pikën 1 të projektvendimit, për shkak të ndryshimit institucional të fushës së përgjegjësisë së turizmit, është parashikuar se kudo në vendim, togjalëshi “Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohet me “Turizmit dhe Mjedisit”.

Për shkak të shtimit të detyrave dhe përgjegjësive të AKT, nga ndryshimet ligjore në ligjin e turizmit, në këtë projektvendim janë parashikuar shtesat e mëposhtme:

Në kreun I, me qëllim realizimin dhe monitorimin e zbatimit të kalendarit turistik gjithëvjetor janë parashikuar shtesat me përbajtjen si vijon:

“8.5/1 “Harton, në bashkëpunim me institucionet qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe grupet e interesit në fushën e turizmit, kalendarin turistik të aktiviteteve zbavitëse duke i orientuar ato për shtrirjet gjeografike si dhe për tematikën e eventeve të preferuara për turistët në këto zona duke koordinuar njëkohësisht edhe realizimin e këtij kalendarit.” dhe

8.5/2 “Orienton, koordinon, dhe promovon kalendarin turistik si dhe monitoron ndjekshmërinë nga publiku e aktiviteteve të këtij kalendarit.”.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për një ndryshim dhe disa shtesa në vendimin nr. 298, datë 20.4.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, i ndryshuar

Për krijimin e mundësisë për mbështetjen nga AKT të projekteve inovative e me karakter krijues, të cilët kanë për qëllim kryesor promovimin e turizmit janë shtuar pikat si më poshtë:

“ 8.6/1 Financojn nga fondi buxhetor i miratuar për çdo vit, realizimin e projekteve të cilat kanë karakter krijues e me objekt të veprimtarisë së tyre turizmin si dhe ngjarje që janë të përfshira në kalendarin turistik, pas miratimit të ministrit.” dhe

“ 8.6/2 Monitoron zbatimin dhe realizimin e projekteve me karakter krijues të cilat kanë për qëllim promovimin e turizmit, si dhe të ngjarjeve që janë të përfshira në kalendarin turistik, të finançuara nga fondi buxhetor i miratuar.” .

Gjithashtu, në këtë projektakt, janë bërë shtesa nëpërmjet të cilave detajohen llojet e shërbimeve të promocionit prej të cilave AKT do të krijojë të ardhura dytësore me përbajte si vijon:

“8.12/1 Krijon të ardhura dytësore nga pagesat e subjekteve të cilëve u ofrohet shërbimi i promovimit të aktiviteteve të tyre në hapësirat e menaxhuara nga Agjencia Kombëtare e Turizmit” dhe

“ 8.12/2 Shërbimet e ofruara nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, të cilat krijojnë të ardhura dytësore janë si më poshtë:

- a) Shërbim i promovimit të aktiviteteve dhe veprimtarive turistike të subjekteve private të interesuara si: hotele, bare, resorte, restorante, qendra tregtare, agroturizëm, qendra estetike, operatorë turistikë, agjenci udhëtimi, SPA, ATM, farmaci, dentist, spital, kompani eventesh etj, nëpërmjet aplikacioneve digitale.
- b) Shërbim i promovimit të subjekteve të interesuara në hapësirat e panaireve kombëtare dhe ndërkombëtare ku Agjencia Kombëtare e Turizmit do të marrë pjesë.
- c) Shërbim në hapësirat e eventeve promovuese të Shqipërisë Turistike brenda dhe jashtë vendit si panaire apo evene të tjera promovuese të kalendareve turistike të aktiviteteve zbavitëse.
- d) Shërbim për promovim në evenete, konferenca, seminare në fushën e turizmit në brenda dhe jashtë vendit, ku Agjencia Kombëtare e Turizmit do të promovojojë Shqipërinë Turistike.

- e) Shërbim i promovimit të aktiviteteve në fushën e turizmi, të subjekteve të interesuara, në ëeb-in e Agjencisë Kombëtare të Turizmit.”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.

Ky projektakt është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe do ti dërgohet për mendim, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme si dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE.

Hyrja në fuqi e këtij projektvendimi do të sjellë efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit pasi AKT, nga fondi buxhetor i miratuar çdo vit, do të financojë projekte dhe veprimtari në fushën e turizmit, të parashikuar në nenin 31 dhe në pikën 14 të nenit 14 të ligjit nr.93/2015, “Për Turizmin” i ndryshuar. Gjithashtu zbatimi i këtij projektakti do të krijojë të ardhura dytësore nga shërbimet e promovimit që do tu ofrojë AKT-ja subjekteve të interesuara, në hapësirat e menaxhuara prej saj.

PROPOZUESI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI